

MARS 2022

BALKANI I QËNDRUESHËM

RIPËRDORIMI SOCIAL I ASETEVE TË KONFISKUARA



SAŠA ĐORĐEVIĆ



BALLKANI I QËNDRUESHËM

Ky studim i shkurtër është pjesë e serisë së Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), të titulluar "Ballkani i Qëndrueshëm", ku trajtohen temat me interes të përbashkët për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) në Ballkanin Perëndimor, të cilat trajtojnë problematikat që ndërlidhen me krimin e organizuar. Ky publikim fokusohet në konfiskimin e aseteve të krimit dhe rishpërndarjen sociale. Ky raport është rezultat i Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore të GI-TOC-së dhe i "Fondit të Qëndrueshmërisë" të GI-TOC-së.

Raporti mbështetet në të dhëna, informacione dhe analiza të mbledhura dhe të ndara nga faktorët e shoqërisë civile, që ndodhen në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në veçanti, gjejmë rastin të falënderojmë Walter Kemp për mbështetjen dhe udhëzimet e tij, anëtarët e tjerë të Observatorit, në veçanti Anesa Agović, Aleksandar Srbinovski dhe Fatjona Mejdinin për komentet dhe ndihmën e tyre, si dhe përfituesit e "Fondit të Qëndrueshmërisë" të GI-TOC-së, që veprojnë në rajon, për pjesëmarrjen e tyre të sinqertë dhe konstruktive gjatë gjithë këtij procesi.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Zyrës së Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e GI-TOC-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë së Gjermanisë.

© 2022 Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë apo material nga ky publikim

nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në asnjë lloj forme apo mënyre pa miratimin me shkrim nga Iniciativa Globale.

Kopertina: © David Franklin / Alamy Stock Photo; Ivan Aleksic, burimi: Unsplash

Për çdo informacion shtesë ju lutemi kontaktoni në adresën e mëposhtme:

The Global Initiative Against Transnational Organized Crime

Avenue de France 23

Geneva, CH-1202

Switzerland

www.globalinitiative.net

PASQYRA E LËNDËS

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME	2
MARRJA E FITIMIT QË KRIJOHET NGA KRIMI	5
RIPËRDORIMI SOCIAL I ASETVE	10
KUADROT LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR RIPËRDORIMIN SOCIAL	11
ETAPAT E RIPËRDORIMIT SOCIAL TË ASETVE TË KONFISKUARA DHE RASTET STUDIMORE	15
T'I KTHESH KOMUNITETIT ATË QË I MORE	21
SHËNIME	22





Hyrja e një hapësire të sigurt për ish-të dënuarit e mitur, në Novi Sad të Serbisë, përpara fillimit të rinovimeve. Shoqëria civile mund të përdorë pronat e konfiskuara për qëllime shoqërore dhe komunitare, madje edhe kur ato janë në gjendje jo të mirë. © "Restart"

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Ripërdorimi social i aseteve (pronave) kriminale të konfiskuara i hap rrugë mundësisë së fuqizimit të qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar dhe të ndërtimit të urave midis shoqërisë civile dhe autoriteteve në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi. Në këtë raport shqyrtohet praktika e ripërdorimit social të aseteve (pronave) të konfiskuara dhe roli që luan shoqëria civile në këtë proces dhe si përfituese e tyre. Gjithashtu, në raport shqyrtohet edhe vendi që zë shoqëria civile në kuadrin ekzistues ligjor dhe institucional për ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara dhe vihen në dukje praktikatat e mira në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, sidomos në Shqipëri dhe Serbi, si dhe dobësitë strukturore.

Ky kërkim është mbështetur në intervistat gjysmë të strukturuar me aktivistë të shoqërisë civile dhe ekspertë, në vëzhgimet e bëra gjatë dialogëve për qëndrueshmërinë, të zhvilluara në secilin prej gjashtë kryeqyteteve të Ballkanit Perëndimor midis shtatorit dhe dhjetorit të vitit 2021, në analizën e të dhënave dytësore dhe pjesëmarrjes në takime (workshop-e) me shoqërinë civile lidhur me përdorimin e aseteve të konfiskuara për kauza të mira, të organizuara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)¹ dhe Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (TASCO).²

Ky studim është vazhdim i përmbledhjes së politikave "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndrueshmërisë së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor".³ Studimi është hartuar në mënyrë të tillë që të rrisë vetëdijesimin lidhur me ripërdorimin social të aseteve të krimit, të vërë në dukje përvojat e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe ta zgjerojë dhe përmirësojë këtë praktikë në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore janë si më poshtë:

- Ripërdorimi social i aseteve të konfiskuara duhet të merret parasysh, nxitet dhe praktikohet në mënyrë më gjithëpërfshirëse në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor si mjet për të treguar se krimi nuk shpërblen dhe si metodë për të krijuar burime në funksion të mbështetjes së viktimave të krimit dhe të krijimit të qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar.
- Asetet e konfiskuara duhet të përdoren me gatishmëri më të madhe për kompensimin dhe mbështetjen e viktimave të krimit, siç ndodh në Serbi, ku Qendra për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit ka marrë një ambient të konfiskuar të cilin e përdor si strehë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Ripërdorimi social i aseteve duhet të promovohet më gjerë, me qëllim që shoqëria civile të informohet rreth mundësive për të aplikuar dhe përfituar nga këto asete ose fonde. Procedurat me të cilat rregullohet dhënia e të ardhurave të konfiskuara të krimit duhet të bëhen më transparente dhe të qasshme, duke dhënë të paktën një përshkrim të asetit që planifikohet të jepet, vendndodhjen dhe gjendjen e tij, dhe duke caktuar një pikë kontakti në agjencinë qeveritare përkatëse.
- Autoritetet qeveritare dhe shoqëria civile duhet të punojnë së bashku për të siguruar transparencën e procedurave që kanë të bëjnë me asetet e sekuestruara dhe menaxhimin efektiv të aseteve, për shembull nëpërmjet një portali publik si "Confiscati bene 2.0"⁴ dhe duke u mbështetur në praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra në Shqipëri dhe në vendet e Bashkimit Evropian (BE) (si Estonia, Italia dhe Rumania).
- Për ripërdorimin social të aseteve duhet të ketë bashkëpunim të besueshëm midis qeverive dhe shoqërisë civile me qëllim që të identifikohen nevojat dhe mundësitë dhe të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia kur është fjala për disbursimin e aseteve të rikuperuara. Diskutimet lidhur me atë se cilat fonde janë të disponueshme dhe si mund të përdoren ato mund të shërbejnë për të ndërtuar ura midis shoqërisë civile dhe qeverisë dhe për të rritur burimet e qeverisë për mbështetjen e punës së OSHC-ve (sidomos si ofruese shërbimi që plotëson ose përkrah veprimtaritë që realizohen nga shteti).
- Shoqëria civile dhe agjencitë e menaxhimit të aseteve duhet të krijojnë dhe të fuqizojnë komunitetet lokale për t'u kujdesur për asetet e konfiskuara.
- Nismat që përdorin asetet e rikuperuara duhet të konsiderohen në kontekstin e promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të

Qeveritë dhe shoqëria civile duhet të punojnë bashkë për të garantuar transparencën e procedurave që kanë të bëjnë me asetet e sekuestruara dhe menaxhimin efikas të tyre.



**Shoqëria civile
duhet të përfshihet
në monitorimin
dhe vlerësimin
e ndikimit që ka
ripërdorimi social i
aseteve (pronave)
të sekuestruara.**

qëndrueshme, sipërmarrjes, trajnimeve profesionale dhe zhvillimit të komunitetit. Në këtë mënyrë, i gjithë komuniteti do të mund të përfitonte në mënyrë të qëndrueshme.

- Projekti i financuar nga BE-ja, i titulluar "Përdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale" (CAUSE), dha rezultate të mira në Shqipëri dhe mund të zbatohet edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.
- Shoqëria civile duhet të përfshihet në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit që ka ripërdorimi social i asetëve (pronave) të sekuestruara.
- Sektori privat (sidomos bankat dhe zyrat e kontabilitetit) dhe organizatat që kanë njohuri praktike të rëndësishme, si Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin dhe OSBE-ja, duhet t'i ndihmojnë qeveritë e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor që të fuqizojnë kapacitetet e tyre për të sekuestruar asetet dhe për të punuar me OSHC-të për të ndihmuar me ripërdorimin e këtyre burimeve në komunitet.
- Nismat dhe organizatat si Rrjeti Ballkanik Ndërinstitucional i Menaxhimit të Aseteve dhe OSBE-ja, duhet të punojnë edhe me agjencitë qeveritare edhe me OSHC-të në drejtim të përmirësimit të praktikës së ripërdorimit të asetëve për qëllime sociale me synim fuqizimin e qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar.
- Efekti simbolik dhe psikologjik i ripërdorimit social të asetëve të konfiskuara duhet të vihet në dukje duke ekspozuar mënyrën se si kthimi i pronave, kompanive ose hapësirave të gjelbra te komunitetet e prekura nga krimi i organizuar jo vetëm që rishpërndan të ardhurat e krimit në dobi të publikut, por cenon edhe imazhin e aktorëve kriminalë dhe të korruptuar si persona të pasur dhe të paprekshëm. Gjithashtu, kjo do të tregonte që nga krimi nuk mund të nxjerrësh dot përfitime.



Biblioteka "KinFolk Coffee Library" në Durrës të Shqipërisë është pronë e rikuperuar nga krimi, që tani përdoret për të përgatitur ushqim dhe si qendër komunitare shumëkulturore. © Biblioteka "KinFolk Coffee Library", burimi: Facebook

MARRJA E FITIMIT QË KRIJOHET NGA KRIMI

Modeli ideal afarist për çdo kriminel është modeli që ofron një ekuilibër të mirë midis rrezikut të ulët dhe përfitimit të madh. Konfiskimi i të ardhurave nga krimi, nëpërmjet rikuperimit të aseteve, bën që rreziku i kryerjes së aktiviteteve kriminale të vazhdojë të jetë i ulët, por të ulëta do të jenë edhe përfitimet e mundshme që do të ketë autori i krimit. Kjo praktikë e bën krimin më pak fitimprurës dhe, për pasojë, edhe më pak tërheqës. OSHC-të në Ballkanin Perëndimor shpesh shprehen të zhgënjyera kur shohin kriminelët dhe politikanët e korruptuar teksa përfitojnë nga veprimtaritë e tyre të paligjshme dhe i mbajnë për vete fitimet e përfituara në rrugë të pandershme. Gjithashtu, ato shprehin keqardhje për mungesën e fondeve që do t'u mundësonin të punonin dhe të ndihmonin dhe përkrahnin komunitetet ku ato punojnë. Konfiskimi i të ardhurave që krijohet nga krimi dhe përdorimi i tyre për të financuar projekte në komunitet ndihmon për t'i trajtuar të dy këto problematika në të njëjtën kohë.

Duhet thënë, megjithatë, se rikuperimi i aseteve nuk është procedurë e thjeshtë. Në përgjithësi, ajo ka katër faza (shih figurën 1). Në fazën e parë, "faza hetimore paraprake", hetuesit mbledhin të dhëna lidhur me të ardhurat e krimit. Në fazën e dytë, ata përcaktojnë pronësinë duke realizuar hetime financiare dhe përgatisin rastin për fazën e tretë (gjyqësore), ku personi i akuzuar ose dënohet ose lirohet nga akuzat, dhe ku merret vendimi për konfiskimin. Në fazën e katërt, shteti i jep asetet e konfiskuara për qëllime të ndryshme, duke përfshirë edhe ripërdorimin e tyre për qëllime shoqërore.⁵




FIGURA 1 Roli i shoqërisë civile në procesin katër fazor të rikuperimit të aseteve.

Logjika që qëndron në themel të rikuperimit të aseteve është që grupet kriminale të organizuara në përgjithësi kanë si motivim fitimin. Ato trafikojnë komoditete të paligjshme si droga dhe armët ose kontrabandojnë mallra të ligjshme si karburanti, ushqimet ose njerëzit. Të ardhurat e krimit zakonisht kalojnë në procesin e pastrimit të parave përmes blerjes së pronave ose bizneseve, dërgohen në llogari bankare jashtë vendit ose shndërrohen në para fizike, kriptovalutë ose mallra të çmuara si makinat dhe jahtet, veprat e artit, bizhuteritë dhe sende të tjera me vlerë. Vlera e këtyre aseteve është aq e madhe saqë i bën buxhetet e shumë OSHC-ve e madje edhe të disa qeverive lokale të duken fare të vogla. Për shembull, vlera prej 15 000 eurosh e një automjeti të konfiskuar është përafërsisht e njëjtë me atë të një granti projektsh për OJQ-të, ndërsa ambientet afariste ose apartamentet luksoze mund të mbulojnë buxhetin që një komunë mesatare (si Peja në Kosovë) heq mënjanë (500 000 euro) çdo vit për kulturën, rininë dhe sportin.⁶ Po të marrim parasysh se sa vlerë të madhe kanë këto investime, është e qartë se edhe ripërdorimi modest i aseteve të konfiskuara do të jetë ndihmesë e madhe për komunitetet në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Indeksi Global i Krimit të Organizuar për vitin 2021 tregon se katër nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia) bëjnë pjesë në dhjetë vendet me notat më të larta në Evropë në aspektin e krimit të organizuar. Më tej, shtrirja, shkalla dhe ndikimi i tregjeve të paligjshme në këto katër vende janë, të gjitha, mbi mesataren globale.⁷ Kjo do të thotë se ekziston një numër i lartë kriminelësh në Ballkanin Perëndimor ose që vijnë nga ky rajon, dhe që bëjnë para të shumta. E, megjithatë, fare pak prej aseteve të tyre kriminale sekuestrohen. Kjo mund t'u vishet, pjesërisht, notave të ulëta të të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket qëndrueshmërisë, të cilat janë pasqyrim i sistemeve të dobëta ose të komprometuara të drejtësisë dhe transparencës dhe llogaridhënies jocilësore të qeverisë. Në fakt, 92% e qytetarëve në Ballkanin Perëndimor e perceptojnë krimin e rëndë, të organizuar dhe financiar si sfidën më urgjente të sigurisë që duhet trajtuar në rajon.⁸

Konfiskimi dhe sekuestrimi i pasurive është pjesë kryesore e instrumenteve ndërkombëtare ligjore që përdoret për luftën ndaj krimit, siç janë "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit". Krahës kësaj, BE-ja nxit marrjen e masave që bëjnë të mundur që pronat e konfiskuara të përdoren për interesin e publikut ose për qëllime sociale.⁹ Pavarësisht natyrës jodetyruese të Direktivës së vitit 2014 të BE-së "Për ripërdorimin social", 19 nga 27 shtete anëtare kanë legjislacion të posaçëm për konfiskimin e pronave për interesin e publikut ose për qëllime sociale,¹⁰ çka mund të jetë stimul për qeveritë dhe parlamentet e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Edhe OSBE-ja ka theksuar fuqishëm ripërdorimin social të aseteve, sidomos në Evropën Juglindore.

Të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar legjislacion lidhur me rikuperimin e aseteve dhe kanë ngritur njësi të inteligjencës financiare ose njësi të specializuara për parandalimin e pastrimit të parave, të cilat kanë kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për të shkuar pas të ardhurave të krimit. Me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës në nivel shtetëror,¹¹ të gjitha vendet e rajonit kanë ligje kombëtare që parashikojnë konfiskimin e pasurive që u përkasin personave të dënuar në rastet kur besohet se kriminelë përfiton ekonomikisht nga krimi dhe/ose kur rrethanat e rastit sinjalizojnë se pasuria është nxjerrë nga veprimtari kriminale. Gjithashtu, ato kanë krijuar organe kombëtare që kanë kompetencë të administrojnë asetet e konfiskuara dhe të publikojnë statistika lidhur me konfiskimin e parave fizike dhe aseteve të tjera. Këto kuadro ligjore paraqiten përmbledhtas në figurën 2.

Shqipëria ka legjislacion (i cili ka marrë për shembull praktikën më të mirë italiane, të njohur me termin "Ligji "Rognoni-La Torre"" të vitit 1982) me të cilin barra e provës kalon nga prokuroria tek i pandehuri dhe u mundëson autoriteteve të marrin masa kundër aseteve kriminale dhe jo thjesht kundër faktorëve kriminalë.¹² Mali i Zi po përgatit ndryshime për ligjin për konfiskimin e të ardhurave të fituara nga krimi, duke u përqendruar te nisja e hershme e hetimeve financiare dhe te fuqizimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit midis institucioneve.¹³ Megjithatë, shoqëria civile dhe prokuroria në Malin e Zi kanë paralajmëruar se institucionet nuk kanë kapacitet për të zbatuar propozimet e reja dhe kanë bërë thirrje për konsultime të mëtejshme.¹⁴

		SHQIPËRIA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA	KOSOVA	MALI I ZI	MAQEDONIA E VERIUT	SERBIA
LEGJISLACIONI	Ligji për konfiskimin e aseteve të siguruara në mënyrë të paligjshme						
	Dispozita specifike për konfiskimin, në kuadër të ligjeve për luftën kundër krimit të organizuar						
	Legjislacioni parashikon konfiskim të zgjeruar (të të ardhurave të fituara nga krimi)						
	Legjislacioni i mundëson qeverisë të ripërdorë asetet e konfiskuara						
	Legjislacioni parashikon ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara						
	Prania e agjencisë kombëtare/një organi për asetet e konfiskuara		 (vetëm në nivel autoriteti)				
ZBATIMI	Konfiskimi i aseteve						
	Konfiskimi i zgjeruar i aseteve						
	Ripërdorimi, nga qeveria, i aseteve të konfiskuara						
	Ripërdorimi social i aseteve të konfiskuara						



Ligji
ekziston



Ligji zbatohet



Nuk ekziston/nuk zbatohet

FIGURA 2 Roli i shoqërisë civile në procesin katër fazor të rikuperimit të aseteve.

Burimi: Mbështetur në informacionet e disponueshme rreth legjislacionit aktual për rikuperimin e aseteve në secilin vend dhe në shqyrtimin e raporteve për zbatimin e këtij legjislacioni.

Megjithatë, pavarësisht ekzistimit të ligjeve dhe institucioneve të nevojshme, në shumë prej juridiksioneve të të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, procesi i drejtësisë penale—nga zbulimi fillestar i krimit deri te vendimi gjyqësor i formës së prerë dhe sekuestrimi i pronës—është i ngadaltë dhe mund të zgjasë deri në disa vjet. Hetimet financiare nuk kryhen gjithmonë në bashkërendim me hetimet penale. Edhe kur ka raste të suksesshme të ndjekjes penale, asetet që sekuestrohen janë të pakta ose ndonjëherë nuk sekuestrohet asnjë aset. Gjithashtu, ka pak informacione lidhur me sendet e konfiskuara.¹⁵

Situata në Maqedoninë e Veriut pasqyron prirjet në mbarë rajonin. Midis viteve 2010 dhe 2019, 670 nga 2 496 raste penale të monitoruara u çuan në Departamentin për Ndjekjen Penale të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Gjykatën Komunale të Shkupit (tani Gjykata Penale). Nga këto 670 raste, pati konfiskim prone në vetëm 36 prej tyre.¹⁶ Sipas një studimi të vitit 2019 të koalicionit "Gjithçka për gjykime të drejta" ("All for Fair Trials"), me seli në Shkup, midis viteve 2015 dhe 2019, gjykatat urdhëruan konfiskimin e pasurive nga vetëm 1% e të gjithë kriminelëve të dënuar.¹⁷ Për pasojë, kriminelët mbarojnë dënimin dhe pastaj i rikthehen plaçkës së tyre, ose asetet e tyre, pasi ruhen në magazina për shumë vite, amortizohen dhe nuk kanë ndonjë dobi të madhe as për ta dhe as për shoqërinë.

Në fakt, në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor asetet që janë konfiskuar kanë qenë relativisht të pakta. Në vitin 2020, vlera e përlogaritur e aseteve të konfiskuara paraprakisht ishte 19 milionë euro në Kosovë,¹⁸ 11,5 milionë euro në Bosnjë dhe Hercegovinë,¹⁹ dhe 4,7 milionë euro në Shqipëri.²⁰ Midis viteve 2015 dhe 2019, në Maqedoninë e Veriut u sekuestruan rreth 9 milionë euro.²¹ Numrat tregojnë se, në mënyrë paradoksale, dy vendet që janë më pak të pajisura për të realizuar ripërdorimin social të pasurive—Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova—kanë sekuestruar sasinë më të madhe të të ardhurave të krimit. Në Serbi, gjykatat pranuan dy kërkesa për konfiskim të përhershëm të aseteve të katër personave,²² ndërsa në Mal të zi, u morën 12 vendime për sekuestrim të përkohshëm, të pronave të paluajtshme, automjeteve, bonove të thesarit dhe parave.²³

Autoritetet e drejtësisë penale në Ballkanin Perëndimor duhet të përmirësojnë rezultatet në aspektin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale.



Të rinjtë e të rejtat përdorin një qendër kulturore në Nish të Serbisë si teatër për të vënë në skenë drama lidhur me kreditë e paligjshme me interesa të larta dhe aftësimin e të rinjve për t'i bërë ballë krimit. © Qendra "Protecta", burimi: Facebook

RIPËRDORIMI SOCIAL I ASETEVE

Në shumicën e rasteve, kur bëhet rikuperimi i aseteve, ato konfiskohen nga shteti dhe vlera i kalon buxhetit të shtetit. Asetet përdoren edhe për të mbështetur projektet lokale, të cilat janë në qendër të këtij studimi. Kemi të bëjmë me procesin e "ripërdorimit të drejtpërdrejt social të aseteve" atëherë kur autoritetet kompetente i vënë asetet e konfiskuara në dispozicion të publikut, p.sh. duke shndërruar një shtëpi që ka qenë pronë e një kriminelit në shesh lojërash ose kopsht për fëmijë, me kërkesën e përfituesve që i përmbushin kushtet, ku përfshihen OSHC-të ose autoritetet. Kjo praktikë ka qenë e zakonshme në Itali duke filluar nga mesi i viteve 1990.

Nga ana tjetër, kemi të bëjmë me "ripërdorim të tërthortë" atëherë kur të ardhurat e fituara nga krimi shpërndahen nëpërmjet fondeve të posaçme për të kompensuar viktimat e krimit, për të investuar në parandalimin e krimit, për të financuar projekte për trajtimin e personave që kanë varësi nga droga, ose për të mbështetur agjencitë e zbatimit të ligjit.²⁴

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës, kanë rregullore me të cilat lejohet ripërdorimi i aseteve të konfiskuara për përdorim social. Kuadrin ligjor më të fuqishëm e ka Shqipëria, ku zbatohet ripërdorimi i tërthortë: për të parandaluar krimin, është krijuar një fond i posaçëm me para të fituara nga asetet e konfiskuara, të cilat mund të përdoren për projekte shtetërore ose komunitare në sferën e parandalimit të krimit dhe edukimit ligjor.²⁵ Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, përparësi i është dhënë shitjes së aseteve të konfiskuara. Për shembull, autoriteti i menaxhimit të aseteve mund të shpallë një tender për dhënien me qira ose shitjen e pasurisë së

paluajtshme, të cilën e përfiton ofertuesi me ofertën më të lartë. Nëse ky proces nuk bëhet brenda një viti, ekziston mundësia që asetet të dhurohen për qëllime humanitare ose t'i mirëbesohen një autoriteti zyrtar që mund t'i ripërdorë ato.²⁶ Në Maqedoninë e Veriut, autoriteti i menaxhimit të aseteve mund t'i japë shoqërisë civile ushqime, veshmbathje dhe pije që janë konfiskuar (për shembull, sepse janë shitur në tregun e zi, janë futur kontrabandë ose janë false).²⁷

Ripërdorimi social nuk është pa sfidat e veta. Në disa raste, ish-pronarët e aseteve bëjnë kërcënime ose shkaktojnë probleme, por rrjetëzimi midis të gjitha palëve të interesuara, ku përfshihet edhe komuniteti lokal, ndihmon në arritjen e një rezultati të suksesshëm. Agjencitë, si administratore të këtyre pasurive shtetërore, janë të detyruara të japin mbështetjen e tyre gjatë gjithë këtij procesi.²⁸



KUADROT LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR RIPËRDORIMIN SOCIAL

OSHC-të luajnë një rol kyç në ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara. Mbi të gjitha, OSHC-të mund të tërheqin më shumë vëmendje drejt praktikës, duke i nxitur qeveritë ta bëjnë konfiskimin dhe ripërdorimin social prioritet të tyre, për shembull, në kuadër të strategjive të tyre kundër korrupsionit. Ato mund të avokojnë për legjislacion të ndërlidhur me rikuperimin e aseteve, të sigurojnë që ligji të parashikojë ripërdorimin social të aseteve kriminale dhe të bëjnë thirrje për ndryshime në reformat institucionale dhe politike.

OSHC-të gjithashtu mund të mbështesin paditë dhe të nxisin procedurat dhe marrëveshjet ligjore për menaxhimin e aseteve. Për shembull, Shoqata Serbe e Prokurorëve ka propozuar një urdhër gjyqësor më specifik në lidhje me pronat, sipas të cilit pronësia mbi asetet e fituara nga veprimtaria kriminale i kalon shtetit.²⁹ Në të njëjtën kohë, OJQ-ja "MANS", e cila trajton korrupsionin dhe krimin e organizuar në Mal të Zi, ka publikuar një grup rekomandimesh ligjore lidhur me konfiskimin e aseteve në mungesë të dënimit të autorit ose konfiskim social.³⁰

OSHC-të gjithashtu mund të mbështesin paditë dhe të nxisin procedurat dhe marrëveshjet ligjore për menaxhimin e aseteve.

Më tej, shoqëria civile mund të luajë funksionin e monitoruesit duke bërë monitorime dhe vlerësime të jashtme të proceseve të menaxhimit të aseteve,³¹ ashtu siç ka bërë organizata "Transparency International" në Bosnjë dhe Hercegovinë.³² Kjo do të garantonte që të dhënat rreth aseteve kriminale të konfiskuara në mënyrë të përhershme të mblidheshin dhe t'i vihehin në dispozicion publikut. Ky lloj monitorimi është i rëndësishëm sepse, kur bëhet fjalë për ripërdorimin social të aseteve, një prej sfidave më të mëdha në vendet e Ballkanit Perëndimor është garantimi i transparencës në lidhje me asetet e konfiskuara, sidomos të atyre që konfiskohen në mënyrë të përhershme, duke shënuar të paktën një përkrahje të asetit, vendndodhjen dhe gjendjen. OSHC-të nga Serbia raportojnë se aktualisht nuk kanë qasje në këto informacione.

Menaxhimi efektiv, efikas dhe transparent i aseteve që u konfiskohen kriminelëve është tepër i rëndësishëm për të ruajtur integritetin e këtij procesi dhe besimin e publikut në këtë proces. Në këtë drejtim, praktika e mirë (që ndiqet, për shembull, në Estoni ose Rumani) është përditësimi i listave publike (p.sh. në një faqe interneti) për mallrat që janë të disponueshme për ripërdorim social dhe dhënia e mundësisë që përfituesit që i përmbushin kushtet të mund të dorëzojnë kërkesa për përdorimin e këtyre mallrave.³³ Nga ana tjetër, integriteti mund të cenohet nga mungesa e transparencës: hetimet e kohëve të fundit në Palermo të Italisë kanë nxjerrë në shesh korrupsionin që ekziston brenda sistemit gjyqësor në lidhje me menaxhimin e aseteve të konfiskuara.³⁴



Një shtëpi pranë Novi Sadit në Serbi, e cila dikur u përkiste kriminelëve, është konfiskuar dhe tani përdoret si shtëpi për personat me autizëm.

© Radio "Evropa e Lirë"

Shoqëria civile mund të punojë edhe me qeveritë për të diskutuar programe strategjike dhe jo thjesht aktivitete që ndodhin vetëm një herë, për të siguruar që ripërdorimi social i aseteve të bëhet në mënyrë të qëndrueshme.

Megjithatë, praktikat më të mira dhe intervistat me ekspertët tregojnë se duhet të përmbushen disa kërkesa përpara se shoqëria civile të mund të marrë pjesë në ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara.³⁵ Në parakushtet e domosdoshme për përdorimin e pasurive të konfiskuara nga shoqëria civile bëjnë pjesë:

- Rikuperimi i aseteve është objektiv i politikave të qeverisë, në të cilin përfshihet një numër i madh palësh të interesuara, duke përfshirë edhe shoqërinë civile.
- Autoriteti që menaxhon asetet e konfiskuara kriminale duhet të jetë funksional.
- Institucionet që sekuestrojnë asetet e luajtshme, pronat e paluajtshme dhe asetet korporative të kriminelëve, duhet të jenë në gjendje t'i ripërdorin ato për dobi të shoqërisë.
- Rregulloret duhet të parashikojnë opsionin për ripërdorimin e aseteve kriminale, pas konfiskimit, për kauza të mira.

Që organizatat e shoqërisë civile të kenë më shumë mundësi për të marrë pjesë në përdorimin e aseteve kriminale të konfiskuara, do të ishte e dobishme nëse:

- Ripërdorimi social i aseteve të konfiskuara kriminale është një prej objektivave të politikave të qeverisë.
- OSHC-të në nivel kombëtar avokojnë në mënyrë të vazhdueshme për konfiskimin dhe ripërdorimin social të aseteve kriminale.
- Të dhënat rreth aseteve kriminale të konfiskuara në mënyrë të përhershme mblidhen dhe bëhen të disponueshme në mënyrë transparente, duke u mundësuar kështu njerëzve dhe OJQ-ve që të hulumtojnë, eksplorojnë, gjejnë ndërlidhjen, shkarkojnë dhe ripërdorin të dhënat me lehtësi.
- Procedurat operative për përfshirjen e shoqërisë civile janë gati dhe zbatohen.

Në figurën 3 jepet një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes aktuale në Ballkanin Perëndimor lidhur me rolin e shoqërisë civile dhe ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara. Kjo tregon se si po e përmbushin vendet e rajonit pjesën më të madhe të kriterëve minimale. Megjithatë, me përjashtim të shembullit të mirë të Shqipërisë, e cila ka një qasje relativisht të përparuar, ka vend për përmirësim. Në të vërtetë, kjo tregon se ka pak transparencë lidhur me asetet e konfiskuara dhe se procedurat për përfshirjen e shoqërisë civile janë ose të paqarta ose nuk ekzistojnë fare. Këto fusha duhet të jenë me shumë në qendër të vëmendjes.

Ripërdorimi social i aseteve kriminale të konfiskuara duhet të jetë objektiv politikash për qeveritë e Ballkanit Perëndimor.

	SHQIPËRIA	BOSNJA DHE HERCEGOVINA	KOSOVA	MAQEDONIA E VERIUT	MALI I ZI	SERBIA
GJENDJA	NIVELI MINIMAL					
Rikuperimi i asetëve është objektiv politikash						
Autoriteti i rikuperimit të asetëve është funksional						
Asetet kriminale konfiskohen						
Ligji parashikon ripërdorimin social të asetëve kriminale						
	NIVELI I PËRPARUAR					
Ripërdorimi social është objektiv politikash						
Ka avokim të vazhdueshëm për ripërdorim social						
Të dhënat rreth asetëve të konfiskuara janë transparente						
Procedura për përfshirjen e shoqërisë civile						
Ekziston Ekziston pjesërisht Nuk ekziston						

FIGURA 3 Përbushja e kërkesave për përfshirjen e shoqërisë civile në ripërdorimin social të asetëve kriminale të konfiskuara në gjashtë vendit e Ballkanit Perëndimor.

Burimi: Mbështetur në informacionet e disponueshme rreth legjislacionit aktual për rikuperimin e asetëve në secilin vend dhe në shqyrtimin e raporteve për zbatimin e këtij legjislacioni.



ETAPAT E RIPËRDORIMIT SOCIAL TË ASETEVE TË KONFISKUARA DHE RASTET STUDIMORE

Si mund të ripërdorin drejtpërdrejt ose tërthorazi OSHC-të pasuritë e sekuestruara? Në Itali, ku rrjete të shoqërisë civile si "Libera" kanë qenë pionierë të kësaj fushe, asetet përdoren për të financuar fushatat për rritjen e vetëdijesimit të publikut rreth krimit dhe korrupsionit, për të financuar bizneset e vogla në fazat e tyre të hershme, për të mbështetur grupet dhe aktivitetet rinore, për të ofruar shërbime sociale (për shembull, për përdoruesit e drogës) dhe për të nxitur ripërtëritjen e komuniteteve lokale.³⁶

Nga viti 2004, organizata italiane "Al di là dei Sogni" ka përdorur parcelat e tokës të rikuperuara nga mafia për të hapur ferma organike në Sesa Aurunka, qytezë në jug të Italisë. Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një modeli të qëndrueshëm social dhe bujqësor nëpërmjet ofrimit të trajnimeve, hapjes së vendeve të punës për grupet e disavantazhuara dhe të marginalizuara dhe përfshirjes së komunitetit lokal në fushatat e ndërgjegjësimi.³⁷ Një OSHC tjetër, "Comitato don Peppe Diana", menaxhon një projekt që ofron një "laborator" ku të rinjtë e të rejtat mund të mësojnë rreth inovacionit shoqëror. Laboratori është i vendosur në një pronë që iu konfiskua mafies.³⁸

Ripërdorimi social i aseteve vërtet mund të jetë zhvillim më i vonshëm në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor sesa në pjesët e tjera të botës, por tashmë kanë dalë në pah disa shembuj të mirë, dhe kjo mund të shihet veçanërisht në Serbi dhe Shqipëri. Në figurën 4, paraqitet kronologjia e disa prej zhvillimeve dhe veprimtarive më kryesore në rajon.



Një ish-klub nate në Fier të Shqipërisë u modelua për t'u përdorur për diçka tjetër: tani është pastiçeria "KeBuono".
© Organizata "Partners Albania", burimi: YouTube

Projekti, i cili kap vlerën prej 450 000 eurosh, ndihmoi në krijimin e një modeli të mirë të ripërdorimit të qëndrueshëm të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar për të mirën e komunitetit.

Në vitin 2009, Serbia miratoi një ligj për sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të fituara nga krimi, i cili u promovua si vegël novatore dhe efektive kundër krimit të organizuar.³⁹ Në të njëjtën kohë, aktivistët e shoqërisë civile filluan të diskutonin rolin e tyre në rikuperimin dhe ripërdorimin social të aseteve, me mbështetjen e rrjetit antikrim "FLARE" (Freedom, Legality and Rights in Europe—Liri, Ligjshmëri dhe të Drejta në Evropë), i cili përbëhet nga organizatat e shoqërisë civile. Në vitin 2010, rrjeti "FLARE" hapi një zyrë rajonale në Serbi,⁴⁰ ndërkohë që anëtarja "PROTECTA" e rrjetit "FLARE" zhvilloi disa konferenca mbi temën e ripërdorimit social, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Serbi. Në vitin 2011, u krijua rrjeti i shoqërisë civile "Veprim Kundër Krimit" (Anticriminal Action—ACRIMA). Rrjeti "ACRIMA" ishte rrjeti i parë që krijohej në Serbi për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe për të rikonfirmuar parimin e ligjshmërisë. Pavarësisht fillimit premtues, mungesa e mbështetjes së donatorëve, e gërshetuar me ndryshimet politike të vitit 2012 të cilat ndikuan të bashkëpunimi midis drejtorisë përgjegjëse për asetet e sekuestruara dhe shoqërisë civile, në fund çoi në mbylljen e veprimtarive.⁴¹ Edhe rrjeti "ACRIMA" ndaloi punën.

Megjithatë, organizata të tjera në Serbi, si Shoqata Kombëtare e Prindërve të Fëmijëve me Kancer (NURDOR) patën më shumë sukses. Organizata "NURDOR" kishte për objektiv të ngrinte një qendër trajtimi në Novi Sad të Serbisë, ku fëmijët që vuajnë nga kanceri të mund të qëndronin me pjesëtarët e familjes së tyre gjatë terapisë. Sigurimi i një shtëpie të konfiskuar nuk ishte gjë e lehtë. Në fillim, autoritetet e hodhën poshtë këtë ide. Këmbëngulja e nismëtares Jolanda Korora dha frytet e veta kur NURDOR-it iu dha një shtëpi e konfiskuar e cila më përpara kishte qenë pronë e Darko Sariçit, kontrabandist i dënuar për drogë.⁴²

Edhe shoqëria civile në Shqipëri ka hapur debatin lidhur me ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara. OSHC-ja "Partnerët Shqipëria për Ndryshim dhe Zhvillim" ka qenë fuqia nxitëse e avokimit për ripërdorimin e qëndrueshëm të aseteve kriminale të konfiskuara dhe për shndërrimin e tyre në hapësira për qëllime shoqërore, kulturore dhe rehabilitimi.⁴³ "Partnerët Shqipëri" kanë organizuar trajnime (workshop-e) për shoqërinë civile në pesë qytete.⁴⁴ Ato u organizuan në kuadër të projektit "CAUSE" të financuar nga BE-ja, të cilin organizata "Partnerët Shqipëri" e zbatoi së bashku me dy OSHC italiane: "Project Ahead" dhe "Comitato Don Peppe Diana" nga viti 2016 deri në vitin 2020. Projekti me vlerë rreth 450 000 euro ndihmoi në krijimin e një modeli të mirë të ripërdorimit të qëndrueshëm të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar për të mirën e komunitetit, model ky i cili mund të kopjohet nga vende të tjera.




FIGURA 4 Kronologjia e arritjeve kryesore lidhur me konfiskimin dhe ripërdorimin social të aseteve në Ballkanin Perëndimor.

Falë mbështetjes së projektit "CAUSE", në Shqipëri, në vitin 2018, u hapën tri sipërmarrje sociale.⁴⁵ Njëra sipërmarrje sociale është pastiçeria "KeBuono" në Fier, e cila ndodhet në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar. Krahas ofrimit të produkteve ushqimore, pastiçeria nxit kulturën e ligjshmërisë dhe ndalimit të dhunës në komunitet, me fokus të veçantë te ish-të burgosurit dhe familjet e tyre. Gjithashtu, aty ofrohen edhe kurse aftësimi profesional dhe aktivitete për të rinjtë e të rejtat. Rreth 75% e personelit janë njerëz që kanë qenë të rrezikuar nga krimi ose kanë qenë viktimat e tij, sidomos të rinj dhe gra.⁴⁶ Siç u shpreh Anisa Xaka, punonjëse e pastiçerisë sociale "KeBuono", ky vend është bërë urë komunikimi për nevojat e komunitetit. Ai që dikur ishte një vend ku zhvilloheshin veprimtari kriminale, tani po bëhet pishtar shpagimi për komunitetin lokal.⁴⁷ - Sfida e vërtetë, - tha Xaka, - është t'ia bëjmë të ditur publikut që sipërmarrja jonë është një model që tregon se si duhet ta marrë nën kontroll komuniteti situatën dhe si t'i përdorë për qëllime të mira pasuritë që dikur i përkisnin krimit të organizuar."

Asetin e dytë të rikuperuar e përdor biblioteka "KinFolk Coffee Library" në Durrës. Kafeneja shërben edhe si qendër shumëkulturore ku ofrohen trajnime, kurse aktrimi, grupe diskutimi, orë mësimore për shah dhe gjuhë të huaja dhe shkolla verore e dimërore. Në vitet 2019 dhe 2020, në veprimtaritë edukative, artistike dhe kulturore që u zhvilluan në bibliotekë, kanë marrë pjesë mbi 150 të rinj e të reja.⁴⁸ Projekti u drejtohet të rinjve që rrezikohen nga delikuenca e të miturve, duke i angazhuar ata në aktivitete shoqërore dhe kulturore të cilat përbëjnë një alternativë ndaj aktiviteteve të paligjshme dhe jetës kriminale. Kur biblioteka u hap në fillim, pati disa probleme me ish-pronarët dhe banorët e ndërtesës ku ndodhet pasuria e konfiskuar. Në fund, çdo gjë shkoi mirë edhe për bibliotekën, edhe për banorët. Menaxheri i projektit u shpreh se, "kur panë gjithë këto rezultate, u bënë klientë të rregullt".⁴⁹

Sipërmarrja e tretë sociale, e themeluar në kuadër të projektit "CAUSE", është Garazhi Social i Artizanatit në Sarandë. Kjo punishte artizanati, e ngritur në një pronë të konfiskuar, përdor gurë natyralë nga plazhet e Sarandës për të bërë punime artizanale që kanë për motiv trashëgiminë kulturore lokale. Tetë gra dhe vajza, të gjitha viktimat e krimit të organizuar ose dhunës në familje ose të rrezikuara prej tyre, u punësuan pas trajnimit fillestar për punimet artizanale me gurë. Garazhi i Artizanatit shërben si platformë për veprimtaritë sociale dhe integrimin.⁵⁰

la vlen të përmendet që në dy rastet e fundit, të dy OSHC-të që zhvilluan sipërmarrjet sociale në fillim hasën në probleme me familjet e ish-pronarëve. Tensionet u ulën nëpërmjet dialogut. Megjithatë, çështja e sigurisë dhe ndërveprimet me ish-pronarët janë probleme që meritojnë vëmendjen e agjencive shtetërore që janë përgjegjëse për dhënien e aseteve të konfiskuara.

Në tetor të vitit 2021, në Shqipëri u hap sipërmarrja e katërt sociale në kuadër të një projekti të

mbështetur nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe OSBE-ja. Kompania, e quajtur "Tradita ime Artizanale", e cila ndodhet në Elbasan, trajnon gratë e pambrojtura të komunitetit dhe krijon vende pune në përdorimin e tezgjahut për prodhimin e qilimave tradicionalë.

Në Shqipëri, asetet e konfiskuara janë përdorur edhe në drejtim të uljes së dëmit që kanë pësuar përdoruesit e drogës, viktimat e trafikimit, të rinjtë dhe gratë.⁵¹ Në disa raste, mjetet e konfiskuara janë modifikuar për t'u bërë biblioteka lëvizëse.⁵²

Gjithashtu, projekti "CAUSE" ka ndihmuar Agjencinë Shqiptare të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në përgatitjen e procedurave për ripërdorimin dhe monitorimin e aseteve të konfiskuara që i lihen në mirëbesim shoqërisë civile.⁵³ Në dhjetor të vitit 2020, agjencia publikoi thirrjen e parë për aplikim nga shoqëria civile për projekte që do të financoheshin nga fondi i posaçëm për parandalimin e krimit.⁵⁴ Në nëntor të vitit 2021, Agjencia nënshkroi kontrata me shtatë OSHC, duke ndarë kështu pothuaj 800 000 euro të ardhura nga asetet kriminale, kryesisht për policinë dhe agjencinë, por edhe për shoqërinë civile.⁵⁵

Ndërkohë, në Serbi, Drejtoria për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ka vazhduar të mbështesë ripërdorimin e pasurive të konfiskuara—në veçanti prona të paluajtshme—për të mbështetur kauzat humanitare. Një sërë institucionesh publike (si bashkitë) dhe organizatash humanitare kanë përfituar prona të konfiskuara. Për shembull, qytetit të Novi Sadit iu dhanë dy shtëpi për të krijuar një shkollë speciale për ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, OSHC-të në Serbi kanë kritikuar mungesën e transparencës, si për vendimet e marra nga drejtori i Drejtorisë në mungesë të procedurave të qarta ose procesit konkurrues,⁵⁶ ashtu edhe për rastet kur Drejtoria nuk u përgjigjej kërkesave të OSHC-së për ripërdorimin e pasurisë së paluajtshme të konfiskuar.⁵⁷

Midis përvojës serbe dhe shqiptare me ripërdorimin social ka ngjashmëri, por edhe dallime. Në të dy vendet, shoqëria civile ishte nismëtare e

Në vitin 2021, autoriteti shqiptar i menaxhimit të pronave kriminale shpërndau rreth 800 000 euro të ardhura nga krimi, kryesisht për policinë dhe agjencinë, por edhe për shoqërinë civile.

ripërdorimit social të aseteve të konfiskuara, duke u mbështetur kryesisht në përvojën italiane dhe me përkrahjen e organizatave ndërkombëtare, edhe pse në Shqipëri kishte më shumë fonde të disponueshme. Megjithatë, qasja dhe teoria e ndryshimit janë të ndryshme. Shoqëria civile në Shqipëri është përqendruar te krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ku sipërmarrja sociale mund të përfitojë edhe pas përfundimit të projektit dhe avokoi që shoqëria civile të përdorte fondet nga asetet kriminale të konfiskuara, të menaxhuara nga shteti. Nga ana tjetër, shoqëria civile në Serbi është përqendruar te krijimi i rrjeteve për të avokuar për konfiskimin e aseteve të krimit dhe për nxitjen e ripërdorimit social. Megjithatë, pa mbështetjen e donatorëve dhe në kushtet kur mungon bashkëpunimi me organin e menaxhimit të aseteve, pronat e paluajtshme të konfiskuara në Serbi mbeten kryesisht në dispozicion të institucioneve shtetërore dhe rrallëherë i jepen shoqërisë civile.

Katër vendet e tjera të rajonit kanë pasur përvojë të kufizuar me ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara. Në Maqedoninë e Veriut, asetet jetëshkurtra ose me vlerë të ulët janë dhuruar për bamirësi.⁵⁸ Krahas kësaj, gjatë pandemisë "KOVID-19", Agjencia për Menaxhimin e Pronave të Konfiskuara siguroi veshmbathje, këpucë, pajisje kompjuterike, kondicionerë, materiale për bërjen e maskave mbrojtëse, perde dhe vegla kopshtarie për organet e shëndetit publik, spitalet, burgjet dhe kopshtet. Aktualisht, është duke u zbatuar një nismë për dhurimin e lavatriçeve (makina rrobalarëse) me vlerë prej rreth 30 000 eurosh.⁵⁹ Në maj të vitit 2021, qeveria e Maqedonisë së Veriut miratoi një strategji për hetimet financiare dhe konfiskimin e aseteve kriminale, e cila ka në qendër të vëmendjes ngritjen e kapaciteteve institucionale, koordinimin horizontal midis autoriteteve shtetërore, dhe statistikave.⁶⁰ Maqedonia e Veriut është i vetmi vend në rajon që ka miratuar një dokument specifik politikash për rikuperimin e aseteve. Megjithatë, ky dokument politikash nuk i referohet qartazi rolit të shoqërisë civile në këtë proces.

Në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në Republikën Srpska, të ardhurat e konfiskuara të krimit shkojnë në buxhetin federal. Për shembull, midis viteve 2010 dhe 2020, në llogaritë e të ardhurave publike të Republikës Serbe janë transferuar rreth 260 000 euro të konfiskuara në mënyrë të përhershme. Gjatë së njëjtës periudhë, pasuritë e luajtshme (automjetet, pajisjet kompjuterike dhe drutë për ngrohje) me vlerë të përgjithshme prej 142 000 eurosh iu dhanë institucioneve publike dhe organizatave humanitare.⁶¹ Në dy raste, në vitin 2018, qeveria (me sugjerimin e Agjencisë Federale për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës) i dhuroi rreth 25 000 euro shoqatës "Zemër për Fëmijët me Kancer" në Sarajevë dhe në vitin 2017 furnizoi me materiale ndërtimi Aleancën e Invalidëve të Luftës.⁶²



Aktivistët e shoqërisë civile të organizatës "Juventas" në Podgoricë të Malit të Zi, flasin me të rinjtë e të rejtat rreth të drejtave të njeriut, tolerancës dhe edukimit mediatik. © Organizata "Juventas", burimi: Facebook

T'I KTHESH KOMUNITETIT ATË QË I MORE

Si përfundim, rikuperimi i të ardhurave të krimit dhe ripërdorimi i tyre në komunitet, e bën krimin më pak tërheqës, u mohon kriminelëve pasuritë që mund të ishin përdorur për të financuar më tej aktivitetet e paligjshme dhe për të blerë pushtet. Në vend të kësaj, rikuperimi i pajis institucionet publike dhe shoqërinë civile me burimet aq shumë të nevojshme, fuqizon kulturën e ligjshmërisë, drejtësisë dhe barazisë dhe krijon të mira publike të prekshme.

Me anë të ripërdorimit social të aseteve, të ardhurat e krimit merren dhe u jepen komuniteteve. Ripërdorimi social ndihmon jo vetëm në fuqizimin e qëndrueshmërisë së komuniteteve ndaj krimit të organizuar, por edhe në krijimin e partneriteteve më të ngushta midis shoqërisë civile dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor. Deri më tani, kjo praktikë është përdorur në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor vetëm në një shkallë të kufizuar, por me njëfarë suksesi fillestar. Kjo temë meriton më shumë vëmendje.

SHËNIME


- 1 Strengthening the fight against transnational organized crime in South-Eastern Europe through improved regional co-operation in asset seizure, confiscation, management and re-use [Fuqizimi i luftës kundër krimit të organizuar ndërkombëtar në Evropën Juglindore nëpërmjet përmirësimit të bashkëpunimit rajonal në sekuestrimin, konfiskimin, menaxhimin dhe ripërdorimin e aseteve], Zyra e Koordinatorit për Aktivitetet Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së, 1 qershor 2019, <https://www.osce.org/projects/asset-recovery-in-south-eastern-europe>.
- 2 Call for Registration for EU TACSO 3, P2P Regional Event: Using Confiscated Assets for Good Causes [Thirrje për regjistrim për TACSO-n 3 të BE-së, Eveniment rajonal P2P: Përdorimi i aseteve të konfiskuara për kauza të mira], 18 nëntor 2021 (afati: 15 nëntor deri në orën 17:00 të Evropës Qendrore), Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (TACSO), 10 nëntor 2021, <https://tacso.eu/call-for-registration-for-eu-tacso-3-p2p-regional-event-using-confiscated-assets-for-good-causes-18-november-2021-deadline-monday-15-october-2021/#>; Using Confiscated Assets for Good Causes [Përdorimi i aseteve të konfiskuara për kauza të mira], TACSO, 22 nëntor 2021, <https://tacso.eu/using-confiscated-assets-for-good-causes/>.
- 3 Kristina Amerhauser dhe Walter Kemp, "Së bashku jemi më të fortë: Forcimi i qëndresës së shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, shkurt 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/03/CSO-WBalkans1_ALBANIAN-WEB-2603.pdf.
- 4 Shihni: <https://www.confiscatibene.it/>.
- 5 Salvatore Costantino, The importance of reuse of confiscated assets for social purposes in fighting the illegal economy [Rëndësia e ripërdorimit të aseteve të konfiskuara për qëllime sociale në luftën kundër ekonomisë së paligjshme], Projekti "Tackling Illegal Economy", 2015, <http://www.tieproject.eu/wordpress/wp-content/uploads/tackling/tie5.pdf>.
- 6 Analiza buxhetore për fëmijë në komunat e Prishtinës dhe Pejës 2015, Save the Children, 2015, 17, https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/PolicyOption_Alb001.pdf.
- 7 Balkan countries score poorly on the 2021 Global Organized Crime Index [Vendet e Ballkanit vlerësohen me nota të ulëta në Indeksin Global të Krimit të Organizuar për vitin 2021], Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore, Buletini i rreziqeve 10, tetor-nëntor 2021, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/11/GITOC-SEEOBS-RB-10.pdf>.
- 8 SecuriMeter, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, 2021, https://www.rcc.int/download/docs/WB_SecuriMeter_Infographics_Feedback_preview-IZMJENJENO-lowres.pdf/98da5bf3cdaed5b03d59ce79c6ced2de.pdf.
- 9 Direktiva 2014/42/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 3 prillit 2014, "Për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian", 29 prill 2014, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32014L0042&from=EN>.
- 10 Asset recovery and confiscation: Ensuring that crime does not pay [Rikuperimi dhe konfiskimi i aseteve: Të sigurosh që krimi nuk të pasuron], Komisioni Evropian, COM(2020) 217 përfundimtar, 2 qershor 2020, https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:5776f170-a4b5-11ea-bb7a-01aa75ed71a1.0001.02/DOC_1&format=PDF.

- 11 Ndonëse në nivel federal Bosnja dhe Hercegovina nuk ka legjislacion lidhur me rikuperimin e aseteve, në këtë shtet ka ligje në nivelin e entiteteve: ligji "Për konfiskimin e pasurive të fituara në rrugë të paligjshme me anë të veprave kriminale" (Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës), ligji "Për konfiskimin e pasurisë së fituar me anë të veprave penale" (Republika Serbe) dhe ligji "Për konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme" (Rrethi i Bërkos).
- 12 Shqipëria ndjek modelin e ligjit italian "Rognoni-La Torre" të vitit 1982. Shihni: Barbara Vettori dhe Boban Misoski, Social reuse of confiscated assets in the EU: Current experiences and potential for its adoption by other EU and non-EU countries [Përdorimi social i aseteve të konfiskuara në BE: Përvojat aktuale dhe mundësitë për miratimin e tij nga vendet e tjera anëtare dhe jo-anëtare të BE-së], në T Fiti dhe G Koevski (redaktorë), *Liber Amicorum. Studia in honorem academici Vlado Kambovski septuagesimo anno*, Universitë Cattolica del Sacro Cuore, 2019, 721–738, <https://publres.unicatt.it/en/publications/social-reuse-of-confiscated-assets-in-the-eu-current-experiences--4>.
- 13 Abazović: 'Anti-mafia' law is aimed at confiscation of property of illegal origin [Ligji anti-mafie synon konfiskimin e pasurive me burim të paligjshëm], Qeveria e Malit të Zi, 18 nëntor 2021, <https://www.gov.me/en/article/abazovic-anti-mafia-law-is-aimed-at-confiscation-of-property-of-illegal-origin>.
- 14 Samir Kajosevic, Montenegro Prosecution, Watchdogs, Criticize 'Anti-Mafia' Law Changes [Prokuroria e Malit të Zi, grupet monitoruese joqeveritare, kritikojnë ndryshimet në ligjin "anti-mafia"], BalkanInsight, 1 dhjetor 2021, <https://balkaninsight.com/2021/12/01/montenegro-prosecution-watchdogs-criticize-anti-mafia-law-changes/>.
- 15 Mungesa e qartësisë vjen si pasojë e faktit që vende të ndryshme në rajon ndjekin metodologji të ndryshme në mbledhjen dhe paraqitjen e të dhënave rreth pasurive të konfiskuara ("vlëra" përkundrejt "listës së artikujve"; "vlëra totale e sekuestruar historikisht" përkundrejt "vlërës së ndarë në kategori për vit" etj.), çka e bën të pamundur krahasimin në nivel rajonal.
- 16 Конфискација на имот: Лесно се proneverуваат, но тешко се враќаат парите во буџетот, Focus, 21 janar 2021, <https://fokus.mk/konfiskatsija-na-imot-lesno-se-proneveruvaat-no-teshko-se-vrakaat-parite-vo-budhetot/>.
- 17 Sinisa Jakov Marusic, North Macedonia Promises Better Record on Asset Confiscation [Maqedonia e Veriut premtan arritje më të mëdha në konfiskimin e aseteve], BalkanInsight, 9 gusht 2021, <https://balkaninsight.com/2021/08/09/north-macedonia-promises-better-record-on-asset-confiscation/>.
- 18 Raporti i vitit 2021 për Kosovën, Komisioni Evropian, SWD(2021) 292 përfundimtar/2, 19 tetor 2021, 24, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/document/download/ec34a067-8477-4adc-a123-054b7d62abc4_en.
- 19 Raporti i vitit 2021 për Bosnjën dhe Hercegovinën, Komisioni Evropian, SWD(2021) 291 përfundimtar/2, 19 tetor 2021, 34, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/document/download/b20c3204-68d0-47e7-b344-5e2562a3adce_en.
- 20 Raporti i vitit 2021 për Shqipërinë, Komisioni Evropian, SWD(2021) 289 përfundimtar, 19 tetor 2021, 40, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/document/download/7532fb68-5bd9-4620-ae9c-1df47d34b919_en.
- 21 Конфискуван имот од 9 милиони евра, главно недвижности на „Трансмет“ на Водно, во Скопје и околината, Faktor, 3 dhjetor 2020, <https://faktor.mk/konfiskuvan-imot-od-9-milioni-evra-glavno-nedviznini-na-transmet-na-vodno-vo-skopje-i-okolinata>.
- 22 Raporti i vitit 2021 për Serbinë, Komisioni Evropian, SWD(2021) 288 përfundimtar, 19 tetor 2021, 45, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/document/download/fbe0f0b7-d8ff-4b89-a4ed-af5ccd289470_en.

- 23 Raporti i vitit 2021 për Malin e Zi, Komisioni Evropian, SWD(2021) 293 përfundimtar/2, 19 tetor 2021, 42, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/document/download/6d45cc87-9d19-4f06-a49f-e3690cde3da4_en.
- 24 Barbara Vettori dhe Boban Misoski, Databases to support asset management and social reuse: The case study of the Republic of North Macedonia [Bazat e të dhënave për mbështetjen e menaxhimit dhe ripërdorimit social të aseteve: Rasti studimor i Republikës së Maqedonisë së Veriut], EU and Comparative Law Issues and Challenges Series, 5, 2021, <https://doi.org/10.25234/eclic/18306>.
- 25 Jill Thomas, Combating corruption in the Western Balkans: Strengthening regional cooperation in the field of asset recovery [Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e rikuperimit të aseteve], Qendra për Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE) dhe Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), 2021, https://www.rai-see.org/php_sets/uploads/2021/02/2nd-edition-AR-Report-WB-EN-final.pdf.
- 26 Neni 32, *Zakon o oduzimanju nezakonito stecene imovine krivicnim djelom Federacije Bosne i Hercegovine*, nr. 71/2014, <https://www.fazuo.gov.ba/userfiles/dokumenti/Zakon-o-oduzimanju-nezakonito-stecene-imovine-krivicnim-djelom-fbih-sl.nov.fbih71-14.pdf>; Neni 65, *Zakon o oduzimanju imovinske koristi stecene kriminalnom djelatnoscu*, nr. 58/2015, 47/2019, <https://me.propisi.net/zakon-o-oduzimanju-imovinske-koristi-stecene-kriminalnom-djelatnoscu/>; Neni 58, *Zakon o oduzimanju imovine proistekle iz krivicnog dela*, nr. 32/2013, 94/2016 dhe 35/2019, https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_oduzimanju_imovine_proistekle_iz_krivicnog_dela.html.
- 27 Neni 51, *Закон за управување со конфискуван имот, имотна корист и одзементи предмети во кривична и прекршочна постапка*, nr. 98/2008, http://www.odzemenimot.gov.mk/VPP/Documents/Zakoni/zakon_upravuvanje_odzeme_imot.pdf.
- 28 Using Confiscated Assets for Good Causes [Përdorimi i aseteve të konfiskuara për kauza të mira], TACSO, 22 nëntor 2021, <https://tacso.eu/using-confiscated-assets-for-good-causes/>.
- 29 *Unapredjenje zakonika o krivicnom postupku, Udruzenje javnih tuzilaca i zamenika javnih tuzilaca Srbije*, 2015, https://uts.org.rs/wp-content/uploads/2007/11/unapredjenje.zkp_.pdf.
- 30 Ky njihet edhe me termin "konfiskim jo i bazuar në dënim". Shihni: *Preporuke za uvodjenje gradjanskopravnog oduzimanja imovinske koristi stecene kriminalnom djelatnoscu*, MANS, korrik 2019, <http://www.mans.co.me/wp-content/uploads/2019/09/Preporuke-gradjanskopravno-oduzimanje-imovine.pdf>.
- 31 Guide to the Role of Civil Society Organizations in Asset Recovery [Udhëzues për rolin e organizatave të shoqërisë civile në rikuperimin e aseteve], Forumi i Ukrainës për Rikuperimin e Aseteve, https://star.worldbank.org/sites/star/files/cso_user_guide_ukraine_-_english_final.pdf; Qendra Ndërkombëtare për Rikuperimin e Aseteve, Guide to the role of civil society organisations in asset recovery [Udhëzues për rolin e organizatave të shoqërisë civile në rikuperimin e aseteve], Instituti i Bazelit për Qeverisje, gusht 2020, https://baselgovernance.org/sites/default/files/2020-08/CSOs_Asset_Recovery.pdf.
- 32 "Transparency International" Bosnjë dhe Hercegovinë, Monitoring Report on Confiscation of Unlawfully Acquired Property in Bosnia and Herzegovina [Raporti i monitorimit për konfiskimin e pasurive të fituara në rrugë të paligjshme në Bosnjë dhe Hercegovinë], dhjetor 2016, <https://ti-bih.org/wp-content/uploads/2017/03/Monitoring-Report-on-confiscation-of-Unlawfully-Acquired-Property-in-BIH.pdf>.
- 33 Analizë mbi praktikat më të mira ndërkombëtare lidhur me ripërdorimin nga OJF-të të pronave të konfiskuara, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2017, <https://partnersalbania.org/publication/analysis-of-the-international-best-practices-on-the-re-use-of-the-confiscated-assets-by-csos/>.

- 34 *I beni confiscati e il trolley pieno di soldi, al via il processo d'appello al "cerchio magico" di Silvana Saguto*, La Sicilia, 17 nëntor 2021, <https://www.lasicilia.it/cronaca/news/i-beni-confiscati-e-il-trolley-pieno-di-soldi-al-via-il-processo-d-appello-al-cerchio-magico-di-silvana-saguto-1395907/>; ANSA, Ex-judge Saguto gets 8 ½ yrs [Ish-gjyqtarja Saguto dënohet me 8 vjet e gjysmë heqje lirie], 28 tetor 2020, https://www.ansa.it/english/news/general_news/2020/10/28/ex-judge-saguto-gets-8-12-yrs_80a20efb-c3d2-499c-a757-0f97ff0b4157.html.
- 35 Asset recovery key principles and key elements for an institutional framework [Parimet kyçe dhe elementet kryesore të rikuperimit të aseteve për një kuadër institucional], https://www.bmjv.de/SharedDocs/Downloads/EN/G20/Nine%20Key%20Principles%20on%20Asset%20Recovery.pdf?__blob=publicationFile&v=1; Jill Thomas, Combating corruption in the Western Balkans: Strengthening regional cooperation in the field of asset recovery [Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e rikuperimit të aseteve], Qendra për Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE) dhe Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), 2021, https://www.rai-see.org/php_sets/uploads/2021/02/2nd-edition-AR-Report-WB-EN-final.pdf; Analizë mbi praktikat më të mira ndërkombëtare lidhur me ripërdorimin nga OJF-të të pronave të konfiskuara, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2017, <https://partnersalbania.org/publication/analize-mbi-praktikat-me-te-mira-nderkombetare-lidhur-me-riperdorimin-nga-ojf-te-e-pronave-te-konfiskuara>; *Fattiperbene: Il Riutilizzo Sociale Dei Beni Confiscati In Italia*, Libera, 2021, https://www.libera.it/documenti/schede/fattiperbene_web_1_1.pdf; Intervistë me Xhill Tomasin (Jill Thomas), këshilltare globale për rikuperimin e aseteve, nëntor 2021; Intervistë me Alberto Paskueron (Alberto Pasquero), profesor ndihmës, Università degli Studi di Milano Statale, nëntor 2021.
- 36 *Fattiperbene: Il Riutilizzo Sociale Dei Beni Confiscati In Italia*, Libera, 2 mars 2021, https://www.libera.it/documenti/schede/fattiperbene_web_1_1.pdf.
- 37 Sergio Nazzaro, *Dal bene confiscato alla marmellata biologica: intervista a Paola Perretta*, L'Eurispes, 27 maj 2021, <https://www.leurispes.it/dal-bene-confiscato-alla-marmellata-biologica-intervista-a-paola-perretta/>.
- 38 *Le attività di Casa don Diana: Il progetto F.U.C.I.NA.*, Comitato don Peppe Diana, <https://dongiuseppediana.org/post.php?i=53>.
- 39 *Oduzimanje imovine najjace sredstvo u borbi protiv kriminala*, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Serbisë, 7 korrik 2010, <https://arhiva.mpravde.gov.rs/lt/news/vesti/oduzimanje-imovine-najjace-sredstvo-u-borbi-protiv-kriminala-7-jul-2010..html>.
- 40 FLARE mreza, *Otvaranje regionalne kancelarije za Balkan, Nis, Srbija*, 30 prill 2010, http://www.protecta.org.rs/public_docs/Regionalna_kanc_z_a_Balkan_info.pdf.
- 41 Intervistë me Milan Stefanoviçin, Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile "PROTECTA", nëntor 2021.
- 42 Joland Korora, *inicijatorka osnivanja Roditeljske kuće: Zelja za životom bolesne dece tera te da se postidiš svojih problema*, Moj Novi Sad, 19 shkurt 2016, <https://www.mojnovisad.com/gradske-face/joland-korora-inicijatorka-osnivanja-roditeljske-kuće-zelja-za-životom-bolesne-dece-tera-te-da-se-postidiš-svojih-problema-id7987.html>.
- 43 Shihni: <https://partnersalbania.org/News/trainime-ne-kuader-te-projektit-c-a-u-s-e-perdorimi-i-pronave-te-konfiskuara-per-sipermarrje-sociale/>; Ripërdorimi social i pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar, një mesazh besimi dhe drejtësie sociale, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 13 dhjetor 2019, <https://partnersalbania.org/News/riperdorimi-social-i-pasurive-te-konfiskuara-nga-krimi-i-organizuar-nje-mesazh-besimi-dhe-drejtësie-sociale/>.
- 44 CAUSE Përdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, korrik 2020, <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/09/cause-project-brochure-web.pdf>.
- 45 Po aty.
- 46 Pasticeria sociale "KeBuono", Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2020, https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/02/KeBuono_web.pdf.
- 47 Giulia Baruzzo, *Da club del crimine a pasticceria sociale. L'Albania scopre il riutilizzo dei beni confiscati*, L'Avialibera, 10 mars 2021, https://lavalibera.it/it-schede-517-albania_beni_confiscati_pasticceria_sociale.

- 48 KinFolk Coffee Library, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2020, https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/02/Kinfolk_web.pdf.
- 49 Intervistë me Nensi Dragotin, menaxher projekti i bibliotekës "KinFolk Coffee Library" në Durrës, dhjetor 2021.
- 50 Garazhi Social i Artizanatit, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2020, https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2020/02/Imzhi_web.pdf.
- 51 Për të parë listën e projekteve, vizitoni faqen: <https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Financimet-e-fondit-te-posacem.pdf>.
- 52 Makina të konfiskuara nga grupet e krimit të organizuar i kthehen komunitetit në formën e bibliotekave lëvizëse, Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), 3 dhjetor 2021, <https://aapsk.gov.al/makina-te-konfiskuara-nga-grupet-e-krimit-te-organizuar-i-kthehen-komunitetit-ne-formen-e-bibliotekave-levizese/>.
- 53 CAUSE – Përdorimi i pronave të konfiskuara për sipërmarrje sociale, EU Projects in Albania, <https://euprojects.al/euprojects/cause-confiscated-assets-used-for-social-experimentations/>.
- 54 Thirrje për shprehje interesi për OJF-të e interesuara për financim projektsh nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit, AAPSK, 7 dhjetor 2020, <https://aapsk.gov.al/thirrje-per-shprehje-interesi-per-ojf-te-e-interesuara-per-financim-projektsh-nga-fondi-i-posacem-per-parandalimin-e-kriminalitetit/>.
- 55 Po aty.; Ceremonia e firmosjes së kontratave me OJF-të e shpallura fituese të projekteve, që financohen nga para të konfiskuara nga krimi, me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, AAPSK, 25 nëntor 2021, <https://aapsk.gov.al/ceremonia-e-firmosjes-se-kontratave-me-ojf-te-e-shpallura-fituese-te-projekteve-qe-financohen-nga-para-te-konfiskuara-nga-krimi-me-vendim-te-komitetit-nderinstitucional-per-masat-kunder-krimit-te-or/>.
- 56 Kjo gjetje mbështetet në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në seminarin praktik të datës 5 maj 2021 të mbështetur nga OSBE-ja në Serbi lidhur me temën e ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar. Për të mësuar më shumë lidhur me këtë seminar praktik, shihni: <https://www.osce.org/secretariat/485576>.
- 57 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile nga Serbia, nëntor 2021.
- 58 Jill Thomas, Combating corruption in the Western Balkans: Strengthening regional cooperation in the field of asset recovery [Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e rikuperimit të asetëve], Qendra për Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE) dhe Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), 2021, https://www.rai-see.org/php_sets/uploads/2021/02/2nd-edition-AR-Report-WB-EN-final.pdf.
- 59 *Агенцијата за управување со одземен имот лани донирала предмети во вредност од над 760.000 евра*, 21TV, 22 gusht 2021, <https://mk.tv21.tv/agentsijata-za-upravuvane-so-odzemen-imot-lani-donirala-predmeti-vo-vrednost-od-nad-760-000-evra/>.
- 60 *Стратегијата за јакнење на капацитетите за водење на финансиски истраги и конфискација на имот за периодот 2021-2023 година со акциски план*, maj 2021, https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/strategija_za_jaknenje_na_kapacitetite_za_vodenje_finansiski_istragi_i_konfiskacija_na_imot_za_periodot_2021-2023_godina_so_akciski_plan.pdf.
- 61 Informacione të dhëna nga Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara, Qeveria e Republikës Serbe, maj 2021.
- 62 Informacione të dhëna nga Agjencia Federale për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, maj 2021.



resiliencefund.globalinitiative.net

